



REPUBLIKA E SHQIPERISE
PREFEKTI I QARKUT DURRES

PREFEKTI I QARKUT DURRËS

ANALIZA VJETORE 2021

Nr. _____ Prot.

Durrës, më 24.01.2022

PËRMBAJTJA

- ❑ MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE
- ❑ MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR DHE BASHKITË
- ❑ DREJTIMI I TASK-FORCAVE, KOMITETEVE PËR ÇËSHTJE TË CAKTUARA
- ❑ EMERGJENCAT CIVILE
- ❑ FUNKSIONET E DELEGUARA
- ❑ VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE
- ❑ DETYRAT DHE PRIORITETET PËR VITIN 2022

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

Veprimtaria një vjeçare dhe e përditshme e Institucionit të Prefektit ka konsistuar në realizimin e objektivave, implementimin dhe zbatimin e prioriteteve dhe politikave të Qeverisë. Ka konsistuar në ndërtimin e një marrëdhënie të b/p reciprok si në marrëdhëniet qendrore në nivel vendor ashtu dhe me organet e vetqeverisjes vendore, duke bashkërenduar gjithashtu veprimtaritë e tyre, me qëllim realizimin e objektivave qeverisë në ruajtjen e rendit dhe sigurinë, ofrimin e shërbimeve arsimore dhe shëndetsore cilësore si dhe monitorimin e çdo lloji veprimtarie ligjore të institucioneve në qark.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

- ▶ Institucioni i Prefektit për këtë vit të vështirë ka qënë maksimalisht i angazhuar për periudhën pastërmet, në luftën kundër COVID-19, antikanabisin, sezoni turistik veror, arsimin, ujin e pijshëm, energjinë elektrike, bujqësinë, sigurinë publike, emergjencat, shqyrtimin e ankesave të qytetarëve dhe shërbimin zjarrfikës etj, duke luajtur një rol kryesor në menaxhimin e këtij viti të vështirë dhe koordinimin e veprimeve me anë të mekanizmave ligjore dhe Task-Forcat të krijuar në këtë kuadër.
- ▶ Gjithashtu ka ndjekur në vijmësi të gjitha zbatimet e vendimeve të këshillave bashkiakë në zbatim të vendimeve të Qeverisë për rindërtimin deri në përrurimin e shkollave dhe banesave individuale.
- ▶ Në luftën kundër COVID-19, sipas të gjitha etapave ka mundësuar zbatimin e Vendimeve të qeverisë në terren për zbatimin e protokolleve të MSH.etj.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

Administrata e Prefektit të Qarkut Durrës ka:

- Zbatuar Urdhërat dhe Udhëzimet e ardhura nga autoritetet qendrore.
- Koordinuar punët dhe bashkërenduar veprimtarinë me Degët Territoriale që veprojnë në Qark.
- Koordinuar veprimtarinë ndërmjet vetë Degëve Territoriale si dhe të këtyre me Organet e Vetëqeverisjes Vendore.
- Dërguar informacione, raporte periodike në Këshillin e Ministrave për veprimtarinë e Degëve Territoriale, sipas Urdhërit të Kryeministrit, dhe për probleme të veçanta, sipas Urdhërit të Ministrit.
- Dërguar informacione, raporte mujore në Ministrinë e Brendshme sipas Urdhërit të Ministrit të Brendshëm dhe për probleme të veçanta.
- Parandalimi dhe menaxhimi i emergjencave, lufta kundër COVID-19, kanabisit etj.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

Më **01.06.2021** u zhvillua një takim koordinues ku ishin të pranishëm Zv. Ministri i Brendshëm, Z. Besfort Lamallari, Drejtoresha për Çështjet Vendore dhe Prefekturat në Ministrinë Brendshme znj. Alma Mele, Kryetarja në detyrë e Bashkisë Durrës, Znj. Emirjana Sako, Kryetari i Bashkisë Shijak Z. Elton Arbana, Përfaqësuesi i Bashkisë Krujë Z. Saimir Shuli, N/Dr i Drejtorisë së Policisë Vendore Durrës Z. Agron Çeli, Drejtori për Kufirin dhe Migracionin Durrës Z. Ndue Doci, Shefi i Policisë Rrugore Durrës Z. Andi Ajazi, Drejtori i IKMT-së Durrës Z. Elvion Keçi, Drejtori i Policisë Bashkiake Durrës Z. Vasip Çopa si dhe drejtues të strukturave mbështetëse pranë bashkive.

Qëllimi i këtij takimi ishte nxitja dhe zbatimi i planit të veprimit për sezonin e ri turistik 2021, si dhe nxitja e Kryetareve të Bashkive dhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit për bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë Shtetit dhe IKMT për çështjen e ndërtimeve pa leje apo në tejkalim të lejes, sipas të gjithë parashikimeve të reja të Kodit Penal dhe urdhërit të Ministrit të Brendshëm.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

Më datë 21 maj 2021 morëm pjesë në takimin e dytë të organizuar nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë referuar konsultimeve publike për hartimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021-2026. E pranishme në takim ishte edhe ministrja për arsimin znj. Evis Kushi, e cila u shpreh se është zhvilluar një diskutim me përfaqësues të Këshillit Kombëtar të Arsimit Parauniversitar, i cili pas takimit të parë, Durrësi ishte takimi i dytë i konsultimit publik për hartimin e kësaj strategjie. Për sa i përket arsimit parauniversitar, znj. Kushi nënvizoi edhe pikat kryesore që do të jenë në fokusin e strategjisë.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

Ministrja u shpreh se: “Në fokus kryesor të kësaj strategjie për arsimin parauniversitar do të jenë gjithëpërfshirja dhe barazia në arsim, digjitalizimi, meritokracia dhe zhvillimi profesional i mësuesve, menaxhimi dhe sigurimi i cilësisë në arsim, si dhe shtimi i vëmendjes për zotërimin e kompetencave të të nxënit gjatë gjithë jetës”. Në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026, ministrja Kushi shprehu ndër të tjera angazhimin e plotë të MASR për të ndërtuar një sistem arsimor sa më gjithëpërfshirës, i cili trajton me sukses nevojat individuale të të gjithë fëmijëve, nxënësve e studentëve tanë, duke i trajtuar ata në mënyrë të barabartë dhe me respekt për diversitetin.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME ADMINISTRATËN QËNDRORE

Një tjetër element i diskutuar në takim midis drejtorëve të ZVA-ve, mësuesve, nxënësve dhe prindërve ishte përsosmëria në redaktimin e teksteve shkollore, si dhe shtrirja e shëbimit të mësuesve ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara deri në klasën e dymbëdhjetë. Çdo tekst shkollor pret një vit për t'u certifikuar nga Ministria e Arsimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, ku gjatë një viti nxënësit bashkë me trupën pedagogjike kanë mundësinë të gjejnë mangësi, gabime dhe çdo gjë në lidhje me tekstin, duke i referuar më pas në MA dhe ASCAP.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

TURIZMI

Turizmi është një nga prioritetet kryesore të Qeverisë e Qarkut Durrës që duhet punuar intensivisht për krijimin e mjedisit sa më të pastër dhe kushteve sa më të mira për të gjithë turistët vendas dhe të huaj që vizitojnë Qarkun gjatë sezonit turistik.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Në drejtim të turizmit dhe mjedisit puna dhe veprimtaria e institucionit të Prefektit është përqëndruar në ndjekjen, koordinimin dhe monitorimin e punës mbi marrjen e masave paraprake në drejtim të sezonit turistik veror 2021 nga të gjithë degët territoriale që ofrojnë shërbime në këtë drejtim si dhe masat e marra nga Njësitë e Vetqeverisjes Vendore, kjo edhe në përballje me pandeminë edhe respektimin e masave dhe rregullave anti-COVID. Punën tonë e kemi nisur që herët duke përcaktuar objektivat, detyrat dhe masat tona në mënyrë që sezoni i ri turistik të na gjente në kushte sa më optimale. Kemi kërkuar nga çdo institucion përgjegjës hartimin e planeve të veprimit me afate kohore të mirëpërcaktuara.

Gjatë fazës parapregatitore për sezonin turistik veror 2021 , por edhe në vazhdim jemi munduar të zhvillojmë takime konkrete me strukturat e njësitë e vetqeverisjes vendore, me degët territoriale, institucionet e administratës shetërore kryesisht në drejtim të përmbushjes së disa elementëve bazë që përbëjnë dhe mbështesin sektorin e turizmit.

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR


Gjatë muajit Maj dhe javët e para të muajit Qershor në interes të masave të mara nga degët territoriale dhe Bashkia Durrës,

Më datë 10.05.2021 Prefekti zhvilloi disa takime me drejtuesit kryesorë të Institucioneve që funksionojnë në territorin e Portit Detar Durrës. Ndër takimet që zhvilloi ishin: Një takim me Drejtorin e Autoritetit Portual Durrës, në lidhje me sezonin e ri turistik veror 2021. Në këtë takim u diskutua mbi masat e marra dhe përgatitjen për sezonin turistik në mënyrë të veçantë në krijimin e të gjithë kushteve dhe infrastrukturës së nevojshme në drejtim të hyrje daljet e udhëtarëve dhe mjeteve, por edhe përpunimit të mallrave të ndryshme me mjete të transportit. Kështu gjatë muajit Maj është bërë i mundur përmirësimi i infrastrukturës portuale me qëllim lehtësimin e aksesimit për përdoruesit e Portit të Durrësit, ku Autoriteti Portual Durrës, ka përfunduar rehabilitimin e infrastrukturës tokësore për mjetet TIR drejt hyrjes së Skanerit të Doganës dhe Terminalit Lindor.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Më datë **11.05.2021** Prefekti zhvilloi një takim dhe me drejtuesin e Drejtorisë Vendore të Policisë së Kufirit dhe Migracionit në kuadër të masave të marra në drejtim të sezonit turistik. Nga drejtori i kësaj strukture u informua mbi miratimin e ligjit të ri Nr. 127/2020 “Për rregjistrimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollit e mjeteve lundruese turistike dhe te argëtimit”, duke shfyqizuar ligjin 8663, të vitit 2000 si dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij. Aktualisht ende nuk kishin dalë udhëzimet e e parashikuar në këtë ligj, megjithatë Drejtoria Vendore për Kufirin e Migracionin Durrës kishte dhënë mendimet e saj lidhur me këto Udhëzime që lidhen me detyrat e Policisë Kufitare. Ligji i Ri është punuar me strukturat vartëse për njohje dhe rritjen e nivelit profesional të tyre.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Më datë 17.05.2021 Prefekti zhvilloi një takim-inspektim me Drejtorin e Ndërmarrjes Komunale Plazh për problemin e pastrimit të vijës bregtare nga prurjet e shumta të leshterikut dhe të mbetjeve të tjera në këtë zonë. Kjo ndërmarrje aktualisht kishte vazhduar punën me intensitet. Deri në atë kohë ishin larguar mbi 100 kamionë me leshterik dhe duheshin afërsisht edhe 150 të tjerë që kjo zonë të pastrohet përfundimisht . Pasi të kryhej pastrimi tërësor i bregdetit do të niste puna për plugimin dhe dezinfektimin e rërës që pastron tërësisht të gjithë plazhin e Durrësit duke e bërë atë në kushte optimale pastërtie. Në përfundim të inspektimit Prefekti kërkoi angazhimin maksimal të kësaj drejtorie në përmbushjen e detyrave kryesore, të pastrimit, plugimit dhe dezinfektimit të rërës para fillimit të sezonit turistik.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Më datë **08.06.2021** u zhvillua takimi në Autoritetin Portual Durrës në lidhje me zbatimin e Planit të Masave në kuadër të sezonit turistik në b/p me të gjithë aktorët pjesmarrës në port. Në këtë takim ishin të pranishëm Prefekti i Qarkut z.R.Nasto, Dr.APD z. Pirro Vengu, Dr.Policisë Kufitare dhe Migracionit z.N.Doçi, Dr.Doganave z. B.Kosta, Shefi i Sigurisë Portuale A Velaj, Kapiteni i Kapitenerise Portit z.T.Allkaj, përfaqësuesi i AFTOS (kontraktori i terminalit të pasagjereve). Ky plan ndiqej dhe zbatohet me respektimin e të gjithë procedurave që normojnë punën e APD në aspektin e kontrollit dhe menaxhimit të hyrje-daljeve në territorin e Portit si dhe për të krijuar kushtet optimale dhe klimë të qetë për udhëtarët dhe operatorët si dhe mjetet lundruese turistike. Ky plan masash u zbatua nga të gjithë institucionet, drejtoritë dhe stafet e tyre përgjatë periudhës 15/6/2021 deri 15/9/2021.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Më datë **12.05.2021** Prefekti ka zhvilluar një takim online me Ministrin e Turizmit dhe Mjedist z. Blendi Klosi për masat e marra për sezonin e ri turistik në qarkun Durrës dhe kryesisht në lidhje me pastrimin e zonave turistike nga Njësitë e Vetqeverisjes Vendore dhe strukturat e tyre mbështetëse. në takim u la detyrë hartimi i një plani të gjerë pastrimi të territorit me angazhimin e strukturave të Njësive të vetqeverisjes Vendore (Durrës, Shijak, Krujë) si dhe mbështetjen e këtyre njësive edhe nga degë territoriale të caktuara për një pastrim sa më të mirë të zonave problematike turistike në qarkun Durrës. Pikërisht për këtë gjë u hartuar edhe një planë veprimi pastrimi, i cili u zbatua mirë.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Më datë 22.06.2021 në mjediset e Hotel Bleart, Prefekti i Qarkut Durrës organizoi mbledhjen e Komitetit Rajonal të Zhvillimit të Turizmit.

Në këtë takim ishin të pranishëm: Ministri i Turizmit dhe Mjedisit Z.Blendi Klosi, Kryetarja në detyre e Bashkisë Durrës Znj. Emiriana Sako, Drejtues të Degëve Territoriale të Qarkut, Sipërmarrës, Operatorë Turistik etj.

Pas hapjes së takimit, nga Prefekti i Qarkut u bë prezantimi i materialit mbi veprimtarinë e deritanishme, punën e bërë, nismat dhe masat e marra nga të gjithë institucionet, problematikat e hasura nga sezoni i kaluar si dhe detyrat që do të ndiqen në vazhdimësi për mbarvajtjen e sezonit turistik veror 2021.

Ky takim vjen pas një pune përgatitore me takime inspektive e verifikime në terren në drejtim të shërbimeve dhe infrastrukturës së nevojshme të ofruar nga të gjithë aktorët e përfshirë në këtë Komitet.

Takimi pati pjesmarrje të kënaqshme të antareve dhe të Operatoreve Turistik të cilët diskutuan në lidhje me problematikat e hasura, punën e bërë, detyrimet që kanë për periudhen në vazhdim si dhe mbi krijimin e urave të bashkëpunimit ndërinstytucional për çdo problematikë apo situatë në funksion të një menaxhimi sa më të mirë të sezonit turistik 2021.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Ministri Klosi vlerësoj këtë takim si një shenjë pozitive e ndërveprimit mes të gjithë aktorëve të përfshirë drejt një objektiv kryesor atë të një sezoni të mbarë si për turistët, ashtu edhe për çdo qytetar e sipërmarrës. Gjatë takimit u nënvizua se Bashkia e Durrësit i ka marrë masat për mbarëvajtjen e sezonit turistik. Të gjitha ndërmarrjet e varësisë dhe infrastruktura përkatëse janë në dispozicion për çdo nevojë dhe problematikë. Burimet njerëzore kanë qenë në krye të detyrës për ta menaxhuar me sukses edhe këtë sezon turistik. Problematikë serioze mbetet çështja e evadimit të mbetjeve urbane nga kjo bashki, e cila po punonte për përmirësimin e situatës. Në përfundim nga Prefekti u prezantuan objektivat e punës dhe çfarë kërkohet për 2021 në zbatim të akteve ligjore në mënyrë që të krijojmë jo vetëm klimën e duhur për një turizëm bashkëkohor dhe të standartizuar, por në të njëjtën kohë të krijojmë mundësinë që sektori i turizmit të shërbejë si një nxitës i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik për qarkun tonë dhe më gjerë.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Konkluzione dhe problematika të hasura në drejtim të sezonit turistik veror 2021

Ndër arritjet dhe problematikat kryesore që u konstatuan përgjatë sezonit turistik veror 2021 përmendim.

1. Sezoni turistik veror konsiderohet i suksesshëm, për sa i përket **nivelit të sigurisë** të ofruar nga strukturat e policisë në të gjitha plazhet dhe zonat turistike, të cilat u frekuentuan nga një fluks në rritje i turistëve të huaj dhe vendas. Gjatë këtij sezoni nuk është shënuar asnjë ngjarje aksidentale me përdorimin e mjeteve lundruese
2. Ka patur një koordinim të punës dhe mirëmenaxhim të strukturave portuale në drejtim të hyrje-daljes së udhëtarëve dhe mjeteve, trageteve, jahteve, kroçerave etj apo dhe ofrimin e shërbimeve të ndryshme në hapsirën portuale.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

1. Gjatë këtij sezoni turistik i gjithë sistemi shëndetësor në nivel qarku, duke përfshirë edhe 4 Qendrat Shëndetësore-verore të ngritura në zonën bregdetare kanë qënë në gadishmëri 24/7, si dhe është ndjekur me përparësi prioritare nga të gjithë strukturat e shëndetësisë, por jo vetëm situata e pandemisë e COVID-19. Janë zbatuar protokollat e sigurisë. Nga ana e shërbimit të epidemiologjisë është bërë hetimi epidemiologjik i të gjithë rasteve covid pozitiv si shtetasve shqiptarë ashtu edhe pushueve të huaj, ku për periudhën Qershor-Shtator janë bërë në total 11651 testime, ku 2559 prej tyre kanë rezultuar covid pozitiv.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

4. Gjatë sezonit turistik, në rrethin e Durrësit janë bërë **10 trajtime dezinfektimi**, duke nisur nga data **07.06.2021 deri më dt 29.09.2021**, proces ky i cili është monitoruar nga Shërbimi i Epidemiologjisë dhe Shëndetit Mjedisor si dhe nga ISHP Tiranë
5. Ka patur vonesa në marrjen e masave paraprake në kohë nga disa institucione në drejtim të krijimit të infrastrukturës së nevojshme për sezonin turistik veror 2021. Kjo gjë ka ardhur si rezultat i situatës në të cilën qarku ynë ka kaluar siç ishte periudha e Post tëmetit të Nëntorit 2019, por edhe pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.
6. Gjithashtu problematikë ka qenë edhe pamjaftueshmëria e një planifikimi dhe zbatimi në afate kohore të mirëpërcaktuara të detyrave, funksioneve dhe përgjegjësive përkatëse që kanë institucionet në bazë të ligjit. Padyshim që këto problematika vijnë edhe si rezultat i disa faktorëve siç janë ato organizativ, financiar, burimeve njerëzore, mjeteve, planifikimi i investimeve, realizimi i të ardhurave etj.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

4. Ka patur vonesa në procesin e miratimit të subjekteve për zhvillimin e aktivitetit në plazhet private, vonesa të cilat kanë ardhur zinxhir që nga saktësimi i hartëzimit të vijës bregdetare, përcaktimit të subjekteve nga NJVV në parcelat përkatëse, lidhjen e kontratave të subjekteve në kohë si dhe plotësimin e disa kriterëve dhe detyrimeve që u lindin subjekteve private që ushtrojnë këtë aktivitet në përmbushje dhe zbatimit të VKM-së Nr.171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores "Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit" si dhe zbatimin dhe rregullave dhe masave të përcaktuara anti-COVID nga Komiteti për Sigurinë, Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

8. Mjaftë pozitive ka qënë realizimi i të ardhurave nga Bashkia Durrës në drejtim të arkëtimit të të ardhurave nga subjektet që ushtrojnë veprimtari si plazhe private. Të ardhurat e përfituara nga parcelat e plazheve të vijës bregdetare të Durrësit janë **79.180.600 lekë**. Të ardhurat e përfituara nga Taksa vendore në shërbime në hotel janë **9.070.365 lekë**.
9. Problematikë e theksuar ka qënë mosprezenca e rojeve bregdetare të liçensuar dhe kullave të vrojtimit në drejtim të sigurisë së jetës së pushuesve edhe pse VKM dhe kontratat ua indikojnë këtë gjë subjekteve private.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

- x. Gjatë periudhës së sezonit turistik dhe jo vetëm, është konstatuar si problematikë serioze ajo e evadimit të mbetjeve urbane, e cila ka ardhur për arsye teknike, organizative dhe financiare. Kjo situatë ka ardhur edhe për faktin e mbylljes së VGM të Porto Romanos, zonë e shpallur emergjencë mjedisore për tu rehabilituar, duke u kthyer në ECO Park. Nga qershor 2020 – deri në gusht 2021 depozitimi i mbetjeve të Bashkisë Durrës u bë në landfillin e Sharrës, si operator pritës pa kontratë, me mbështetje të pushtetit qendror, për situatën ku ndodhet qyteti i Durrësit. Pamundësia për të patur një VGM sipas kriterëve ligjore në bashkinë Durrës dhe koston e transportit të mbetjeve urbane në inceneratorin e Sharrës krijoj disa vështirësi të cilat si pushteti vendor ashtu edhe ai qendror u munduan që të gjenin një zgjidhje optimale në kohë.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

11. Është konstatuar një papërgjegjshmëri e qytetarëve dhe subjekteve të ndryshme në hedhjen e mbeturinave në vende që nuk janë të përcaktuara si pika ngrumbullimi çka vështirëson punën e ndërmarrjeve në këtë drejtim. Lind nevoja e përcaktimit të një orari të caktuar dhe detyrimit të subjektet me aktivitet Hotel, Bar-Restorant për hedhjen e mbeturinave në kontenierët e përcaktuar nga Bashkia. Për një shërbim edhe më cilësor, kërkohet nga NJVV një planifikim me më shumë fuqi punëtore, mjete dhe investime në drejtim të menaxhimit të mbajtjes pastër të qytetit.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

11. Ka patur një mirëmenaxhim në furnizimin me energji elektrike dhe ujë të pijshëm nga të dy operatorët si OSHEE ashtu edhe Ujësjellës Kanalizime, të cilët kanë ofruar normalisht shërbimet me energji elektrike dhe ujë të pijshëm përgjatë gjithë periudhës së sezonit turistik në të gjithë zonën bregdetare dhe në të gjithë qarkun.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Çfarë kërkohet të përmirohet gjatë sezonit turistik 2022

- Konkretizim maksimal të bashkëpunimit ndërinstitucional në nivel qendror dhe vendor për mbarëvajtjen e sezonit të ardhshëm turistik.
- Rifreskimi i planeve të veprimit për situata të ndryshme me të gjithë strukturat operuese.
- Zbatimin me rigorozitet nga operatorët private të VKM-së Nr. 171, datë 27.03.2019 “Për sigurinë në det, plazhe, në ujërat e brendshme në thellësi të territorit dhe gjatë ushtrimit të sporteve të ujore” si dhe anagazhimin e të gjitha strukturave përgjegjëse për implementimin dhe zbatimin e tij.
- Një rëndesi e veçantë do t’i kushtohet **bashkëpunimit me mediat lokale dhe kombëtare** lidhur me dhënien e informacioneve të ndryshme për sezonin turistik veror 2022.
- **Aktivizimi dhe funksionimi sa më mirë Task Forcës Vendore**, në mënyrë të veçantë për ndarjen e stacioneve të plazhit Privat-publik, vendosjen e kullave të vrojtimit me vrojtues, përcaktimin dhe monitorimin e vendbazimeve të mjeteve motoriike ujore, monitorimin e zhurmave në mjedis, dhe marrjen e masave ndaj subjekteve që veprojnë në kundërshtim me ligjin.

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

ARSIMI

Gjatë viti 2021 Institucioni i Prefektit e ka ndjekur në vijimsi arsimin si një prioritet i qeverisë dhe i yni në qark: Rindërtimin e shkollave, kopshteve, çerdheve, kompletimin me bazë materiale, respektimin e protokolleve për Covid-19 të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe Sportit, realizimin e procesit mësimor dhe edukimit.

Rëndësi i kemi kushtuar ringritjes së shkollave të reja sipas planit të rindërtimit që viti i ri mësimor 2021-2022 t'i gjej nxënësit të ulur në bankat e shkollave të reja, me palestra dhe laborator të rinj.

Vëmendje i kemi kushtuar interesimit të nxënësve për të ruajtur dhe mbajtur shkollat me pastërti shëmbullore dhe për të rritur kujdesin në drejtim të ruajtjes të të gjitha ambjenteve dhe bazës materiale.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Gjatë muajit shkurt 2021 janë kryer kontrolle sipas planit të Institucionit të Prefektit për vijimin e punëve në rindërtimin e shkollës 9-vjeçare “Bedrie Bebeziqi”, shkollës 9-vjeçare “Qemal Mici” dhe çerdhes “Sotir Noka”. Kontrolli kishte për qëllim evidentimin e ecurisë së punimeve për përfundimin e ndërtimit të këtyre inastitucioneve të arsimit parauniversitar dhe parashkollor. Shkolla 9-vjeçare “Bedrie Bebeziqi” ishte e përfunduar, e kompletuar me bazë materiale të re. Dy muaj më vonë më datë 29 prill 2021 u përurua nga Kryeministri Edi Rama, i cili vizitoi shkollën e re 9-vjeçare, ku gjithçka kishte përfunduar dhe fëmijët bashkë me mësuesit iu rikthyen për të vijuar procesin mësimor. Kryeministri vizitoi mjediset e reja të shkollës, bibliotekën e re të shkollës.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Me datë 09.09.2021 Në zbatim të planit të punës Institucioni i Prefektit dhe në zbatim të politikave sektoriale të Këshilit të Ministrave në fushën e arsimit dhe në zbatim të Ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektim e Qarkut” neni 8 pika g dhe b, në kuadër të përgatitjeve dhe masave të marra për fillimin e vitit të ri arsimor 2021-2022, në kushtet e situatës së krijuar nga pandemia e COVID -19, Prefekti i Qarkut Durrës ndoqi në vazhdimësi procesin e përgatitjeve në rang Qarku.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Në prag të hapjes së shkollave dhe fillimit të procesit mësimor në rang Qarku ishin 80 institucione arsimore publike, ku do të studionin 38.488 nxënës. Në të gjithë Qarkun nga Bashkitë dhe ZVA-t u marën masa të mira teknike, organizative dhe logjistike për një fillim të mbarë. Nga të tre bashkitë ishte kryer procesi i dezinfektimit, riparimeve, lyrjeve, pastrimeve dhe furnizimeve me bazë materiale (dezinfektant, detergjent, kite higjenike dhe maska). Ishin vendosur gjithashtu postera orientues dhe shpjegues për masat kundër COVID-19 dhe udhëzues për mënyrën e sjelljes së nxënësve në shkolla. Ndër të tjera shkollat ishte kompletuar tërësisht me sinjalistikën horizontale orientuese për ruajtjen e largësisë së kërkuar sipas proktokollit të Ministrisë së Shëndetësisë kundër COVID-19. Ishte caktuar personeli infermjer për çdo institucion arsimor.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Me datë 4 nëntor 2021 u inspektuan punimet për ndërtimin e shkollave të mesme dhe 9-vjeçare pas dëmtimit nga tërmeti i 26 nëntorit 2019. Rindërtimi i institucioneve arsimore parauniversitare kishte ecuar me ritme të shpejta dhe cilësore, ku Shkolla e Mesme e Bashkuar “Ismet Nanushi” në Kullë, Njesia Administrative Sukth ishte gati për t’u përruar për festat e nëntorit. Shkolla e Mesme “Rexhep Mezini” në Ishëm ishte ende në fazë për të nisur punimet, ndërsa shkolla 9- vjeçare dhe kopshti “Adem Gjeli” po në Ishëm ishte tashmë prej gati një viti tërësisht e re dhe funksionale.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

MJEDISI

Mjedisi ka qënë prioritet i punës tonë përgjatë vitit 2021, kjo jo vetëm në ndjekjen, monitorimin e situatës në qarkun tonë por edhe koordinimin dhe bashkërendimin e punës për çdo problematikë të dalë në këtë drejtim. Gjatë viti 2021 janë zhvilluar takime, trajnime të ndryshme sipas specifikës, janë hartuar plane veprimi në drejtim të pastrimit të territorit duke angazhuar jo vetëm strukturat përgjegjëse por edhe shoqërinë civile e më gjerë. Ndër aktivitetet më të rëndësishëm përmendim:



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Më datë **15.05.2021** në kuadër të aksioneve të ndërmarra për pastrimin e territorit, kryesisht të zonave turistike u asistua dhe u mbështet aksioni i ndërmarrë nga "River Clean Up" në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit me vullnetarë, studentë dhe nxënës të shollave të mesme në aksionin për pastrimin e grykderdhjes së lumit Ishëm. Kjo zonë edhe pse pastrohet vazhdimisht krijon mbetje urbane (plastika, qese e mbetje të tjera) si rezultat i prurjeve nga rrjedha e lumit Ishëm duke i nxjerrë më pas në det ato. Në këtë aksion u angazhuan rreth 200 vullnetarë dhe 150 gjimnazistë dhe studentë, të cilët padyshim u ndeshën me një terren mjaftë të vështirë për të arritur deri atje. Prefekti me struktura të tjera mbështetëse u angazhuan në mënyrë të veçantë në përmirësimin e infrastrukturës rrugore tejet të vështirë për të arritur në këtë zonë nga vullnetarët



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Institucioni i Prefektit në kuadër të detyrave të lëna nga Kryeministri në mbedhjen e datës 22.10.2021 për çlirimin e territorit nga ndotja mjedisore dhe në kuadër të pastrimit dhe higjenizimit gjatë muajve Nëntor dhe Dhjetor 2021 hartoi dhe miratoi këto dokumenta ligjor si më poshtë:

1. Me nr. 902 Prot, datë 11.11.2021 është hartuar dhe miratuar nga Prefekti i Qarkut "Plani emergjent për pastrimin dhe higjenizimin nëntor-dhjetor 2021" në kuadër të nismës "Të çlirojmë territorin nga ndotja mjedisore". Në këtë Plan të Përgjithshëm janë përcaktuar detyrat konkrete dhe institucionet përgjegjëse të cilat do të angazhohen për identifikimin e hot spoteve dhe ndërhyrjeve konkrete në to, në afate kohore të përcaktuara. Ky Plan u është dërguar për ndjekje dhe zbatim të gjithë strukturave përgjegjëse pjesë e Planit.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

2. Urdhëri i Prefektit Nr.79, datë 25.11.2021 "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për marrjen e masave për pastrimin nga mbetjet dhe papastëritë dhe higjienizimit e territorit në qarkun Durrës", i cili ngarkon strukturat përgjegjëse pjesë e Grupit të Punës të monitorojnë situatën mjedisore dhe uljen e ndotjes në qark. Kërkohet strukturimi i një plani masash për veprim, lidhur me rehabilitimin e zonave të ndotura mjedisore në Qarkun Durrës

3. Urdhëri i Prefektit Nr, 80, datë 25.11.2021 "Për ngritjen e grupit të punës ndërinstitucional për marrjen e masave dhe kontrollin e territorit nga ndotjet mjedisore në qarkun Durrës", i cili do të kontrolloj dhe evidentoj institucionet publike dhe subjektet private përgjegjës për ndotjen mjedisore. Ky grup pune përbëhet nga Inspektoriate dhe struktura të cilat kanë detyrë dhe funksion të marrin masa administrative në bazë të kompetencave që përcakton ligji, ndaj çdo institucioni shtetëror apo subjekti përgjegjës për ndotjen e shkaktuar mjedisore.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

4. Në përbushje të "Planit emergjent për pastrimin dhe higjienizimin nëntor 2021", është hatuar tabela e Planit konkret të Veprimit për ndërhyrjet e bëra dhe që do të bëhen në vazhdimësi nga strukturat përgjegjëse të ngarkuara në këtë proces.

Institucioni i Prefektit për këtë qëllim ka zhvilluar takime të vazhdueshme me të gjithë strukturat të cilat janë pjesë e grupeve të punës sipas urdhrave të mësipërm, për të koordinuar dhe bashkërenduar punën si dhe për tu informuar në mënyrë periodike në lidhje me ecurinë e punës në drejtim të mbrojtjes mjedisore.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Bazuar në Planin emergjent për pastrimin dhe higjenizimin Nëntor-Dhjetor 2021, gjatë këtyre muajve në qarkun Durrës nga strukturat e Njësive të vetqeverisjes Vendore dhe Degët Territoriale janë ndërmarë aksione të shumta në drejtin të pastrimit të territorit, kryesisht në pikat më problematike ku kemi mbetje të ndryshme. Vëmendja është përqëndruar në zonat bregdetare, në akset rrugore kryesore, në sheshet publike, në zonat pyjore, kanale etj.

Më kryesoret po i paraqesim si më poshtë;

Bregdeti i plazheve të Bashkisë Durrës, Ura e Dajlanit, rrethrotullimi I Kënetës pranë “Royal Gaz”, kanalet pranë rrugës “Vlazërimi”, akset rrugore Shkozet-Plepa, Durrës-Porto Romano, Durrës-Currila, Fushkrujë-Kamëz, Vorë-Fushkrujë, Fushkrujë-Krujë, Shkozet-Katërrugët, Sukth-maminas, shëtitorja “Taulantia”, Pylli në Sektor Rinia, Pylli në Gjirin e Lalëzit.

Problematika kryesore mbetet hedhja e mbetjeve vend e pavend si edhe nga bizneset. Pallatet e prishura që janë në proces rindërtimi bëjnë shpeshherë pika grumbullimi mbetjesh të ndryshme duke shkaktuar ndotje të madhe.

Prefekti në vazhdimësi ka kërkuar angazhimin maksimal të të gjitha drejtorive përkatëse dhe bashkive duke qëndruar në kontakt të vazhdueshëm për të monitoruar dhe njëkohësisht për të mbështetur në lidhje me çdo problematikë



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Objektivat e punës tonë për vitin 2022 në drejtim të mbrojtjes së mjedisit

Institucioni i Prefektit do të organizoj punën e tij dhe do të koordinoj të gjithë strukturat përgjegjëse në drejtim të mbrojtjes mjedisore në këto drejtime:

- ▶ Vazhdimi i nismës “Të çlirojmë territorin nga ndotja mjedisore”
- ▶ Realizimi i fushatave sensibilizuese për angazhimin dhe edukimin e brezit të ri si dhe ndërgjegjësimin e njerëzve për mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij.
- ▶ Zbatimit të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve brenda territorit të rajonit dhe forcimi i bashkëpunimit midis autoriteteve të pushtetit vendor, qendror dhe sektorit privat
- ▶ Mbrojtja dhe mirëmbajtja e parqeve dhe pasurive natyrore
- ▶ Monitorimi i masave që do ndërmerren për përmbushjen e standarteve mjedisore dhe administrimin e qëndrueshëm të zhurmave nga institucionet përgjegjëse
- ▶ Monitorimin dhe ndekjen e vazhdueshme të punës së grupit ndërinstitucional për marrjen e masave për pastrimin nga mbetjet dhe papastërtitë dhe higjienizimin e territorit të qarkut Durrës

MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

INFRASTRUKTURA

Gjatë vitit 2021 Institucioni i Prefektit i ka kushtuar rëndësi të veçantë infrastrukturës në nivel qarku, kryesisht të infrastrukturës rrugore në sigurinë e rrugëve nacionale dhe atyre vendore. Në këtë kontekst janë zhvilluar takime të ndryshme me të gjithë strukturat përkatëse si dhe janë trajtuar dhe ndjekur çështje dhe procese që kanë të bëjnë me infrastrukturën rrugore dhe të gjithë elementët e tyre, ndër të cilët përmendim:

Takimet e datës 15.04.2021 dhe të datës 14.06.2021, takime në lidhje me çështjet e sigurisë rrugore në tërësi dhe masat paraprake për sezonin turistik veror 2021, me drejtues të ARRSH, të Bashkive, të Policisë së Shtetit, të Policisë Bashkiake, të firmave kontraktuese për rrugët, etj.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte mbi nevojat për përmirësimin e infrastrukturës rrugore dhe sinjalistikës gjatë sezonit veror 2021. Në takie u bëne panoramat e përgjithshme e të gjithë problematikave të hasura në të gjithë akset rrugore nacionale dhe lokale, në veçanti të atyre akseve me akses në zonat turistike. Prefekti kërkoj angazhimin dhe korrdinimin e punës ndërmjet të gjithë strukturave me qëllim përmirësimin dhe zgjidhjen e problematikave në kohë, në drejtim të krijimit të gjithë infrastrukturës apo shërbimeve të nevojshme për sezonin turistik 2021.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Një proces mjaftë i rëndësishëm që është ndjekur gjatë vitit 2021 dhe po ndiqet edhe në vazhdimsi është edhe procesi i kalimit të pronësisë ndërmjet ARRSH dhe Njësive të Vetqeverisjes Vendore të qarkut Durrës, kjo në zbatim të vendimit Nr. 600, datë 13.10.2021 "Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve".

Në lidhje me VKM nr.600 dt. 13.10.2021 për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve, duhet të dimë sa të njohura janë Bashkitë në lidhje me ndryshimet që ka në inventarin e rrugëve për shkak se një pjesë e rrugëve që ka pasur ARRSH i ka kaluar Bashkive. Ka një problem te kjo VKM ku nuk shprehet qartë në lidhje me kalimet e këtyre rrugëve nga një institucion në tjetrin sepse duhet një dispozitë kalimtare, për këtë arsye ARRSH i është dërguar një shkresë ministrisë së infrastrukturës edhe Këshillit të Ministrave që të paktën kjo të shtyhet mbas datës 31 mars meqënëse Autoriteti Rrugor Shqiptar i ka parashikuar fondet, mjetet për mirëmbajtjen e këtyre segmenteve.


MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Aktualisht ky proces është në fazën e përcaktimit të saktë nga njësitë e vetqeverisjes vendore të distancave kilometrike nga qendrat e qyteteve deri në pikat e takimit të tyre me rrugët kombëtare nga qendrat e qyteteve deri në pikën e takimit të tyre me rrugët kombëtare, shoqëruar me koordinatat përkatëse, të dhëna këto që më pas do të azhurnohen në Arkivin Kombëtar të Rrugëve (pra të bëhet azhurnimi i saktë i tyre). Gjatë këtij viti do të bëhet dhe kalimi i pronësisë ndërmjet endeve të rrugëve dhe Njësive të Vetqeverisjes Vendore të qarkut Durrës, i cili do të ngjiqet dhe monitorohet nga Prefekti dhe sektori i Zhvillimit Urban duke koordinuar punën për çdo problematikë që mund të dalë



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Prioritet i punës tonë për 2022 në drejtim të sigurisë rrugore do të jetë pavyshim angazhimi ynë maksimal në ndjekjen e çdo problematike që do të dal si dhe koordinimin dhe bashkërendimin i punës me të gjithë strukturat përgjegjëse për një siguri maksimale në rrugët rurale dhe nacionale që përfshihen në qarkun tonë



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

ENERGJIA ELEKTRIKE DHE UJI I PIJSHËM

Gjatë vitit 2021 nga Institucioni I Prefektit është ndjekur me fanatizëm dhe monitoruar situata e furnizimit me energji elektrike dhe e ujit të pijshëm. Gjatë kësaj periudhe nga punopnjësit e OSHEE-së është bërë e mundur që të gjitha fiderat të jenë në gjëndje pune. Të gjithë strukturat e shërbimit kanë qënë në gadishmëri ndaj situatave të ndryshme në mënyrë të vecantë atyre të defekteve për ta rregulluar në kohë dhe për ta mbajtur në gadishmëri të përhërshme.

Gjithashtu kemi ndjekur dhe monitoruar punën e ndërmarrjes së Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a Durrës në lidhje me ujin e pijshëm, shërbim i cili ka vazhduar normalisht duke kaluar nga **9.1 orë në 12.1 orë** duke rritur mesatarisht 3 orë furnizimin me ujë në të gjithë zonën e shërbimit.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

RENDI DHE SIGURIA

Si rezultat i punës që është bërë në qarkun e Durrësit gjatë 2021 në drejtim të rendit e sigurisë, janë arritur përmirësime konkrete në këto drejtime kryesore:

Garantimi i rendit dhe sigurisë publike në të gjithë territorin e qarkut, nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit me komunitetin dhe rritjes së performancës së shërbimeve policore.

Forcimi i Policimit në Komunitet në Qark.

Garantimi i rendit dhe qetësisë publike në zonat turistike/plazhe gjatë gjithë sezonit turistik veror.



MARRËDHËNIET E PREFEKTIT TË QARKUT ME INSTITUCIONET QËNDRORE NË NIVEL VENDOR

Kontrolli i territorit për identifikimin dhe asgjësimin e bimëve narkotike “canabis sativa” dhe vënien para përgjegjësisë ligjore e autorëve që kryejnë veprimtari kriminale të kultivimit të bimeve narkotike.

Bashkëpunimin e suksesshëm për të garantuar sigurinë ushqimore, ndalimin e përdorimit të bimëve narkotike në mjediset shkollore dhe lokalet publike, sigurinë dhe qetësinë e fëmijëve në mjediset shkollore dhe ato publike etj..

U trajtuan me përgjegjësi dhe janë vjelë rezultate pozitive në drejtim të zgjidhjes së problemeve të ndotjes, dëmtimit dhe menaxhimit të mjedisit.



DREJTIMI I TASK-FORCAVE, KOMITETEVE PËR ÇËSHTJE TË CAKTUARA

- Anëtarët e këtyre Task Forcave, Komiteteve apo grupeve të punës të ngritura nën drejtimin e Prefektit të Qarkut, janë drejtues dhe nënpunës të Institucioneve të administratës shtetërore, të Degëve Territoriale që veprojnë në Qarkë si dhe të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, të cilët gjatë zhvillimit të aktiviteteve kanë marrë pjesë, kanë zbatuar detyrat e përcaktuara sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- Realizimi i këtyre detyrave është kryer nëpërmjet koordinimit të punës dhe bashkëpunimit midis Institucioneve Qëndore dhe Vendore në nivel Qarku.
- Pavarësisht punës së mirë, problem mbetet pjesëmarrja dhe bashkëpunimi ndërmjet institucioneve.

TASK-FORCA

Task Forca Vendore Antikanabis

Gjatë vitit 2021, në territorin e Qarkut Durrës dinamika e kriminalitetit me tendencë kultivimin e bimëve narkotike paraqitet si më poshtë :

84 vepra penale për kultivim të bimëve narkotike zbuluar **45**, me autor **117**, arrestuar **59**, ndaluar **0**, ndjekur në gjendje të lirë **13**, shpallur në kërkim **45**.

Janë konstatuar **700** vende/ambjente kultivimi nga të cilat **689** ambjente të hapura dhe **11** ambjente të mbyllura me gjithsej **56560** bimë narkotike të asgjësuar/sekuestruara, nga të cilat **5884** fidanë në kubikë, **50676** të mbjella në tokë, **0** të mbira vetë dhe **0** në proces tharje.

Proceduar penalisht **16** autorë me detyrë lexues te OSHEE-se, elektrikist Administrator të Njësisë Administrative dhe kryeplak fshatit për veprën penale “Shpërdorim detyrë” dhe “Kultivim të bimëve narkotike”, “Moskallëzim Krimi” e parashikuar nga neni 248, 300 dhe 284 të K.P, nga të cilët arrestuar **5**, ndaluar **0**, ndjekur në gjendje të lirë **8**, shpallur në kërkim **3**.



TASK-FORCA


TASK FORCA VENDORE “PËR MONITORIMIN DHE KONTROLLIN E MASAVE PËR ZBATIMIN E DETYRIMEVE LIGJORE SI DHE SIGURINË NË PLAZHE PËRGJATË SEZONIT TURISTIK VERORË 2021.

Me Urdhër të KM. dhe Ministrit të Brendshëm, gjatë muajit Qershor ka funksionuar Task Forca vendore sipas një plani inspektimit, e cila ka vepruar në të gjithë zonat turistike dhe më gjerë. Vijon puna për goditjen e veprimtarisë kriminale në fushën e zënies së hapësirave publike dhe ndërtimeve të paligjshme nga Drejtoria Vendore e Policisë qarkut Durrës Ky aksion është shtrirë përgjatë gjithë vijës bregdetare.



TASK-FORCA

Gjatë gjithë periudhës Prill-Qershor 2021 është ndjekur dhe monitoruar edhe aksioni për lirim të hapsirave publike dhe mbajtjen pastër të zonës së plazhit dhe bregdetin. Ky aksion është kryer nga Policia e Shteti dhe Policia Bashkiake në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit në zbatim të planit të masave për të garantuar një sezon turistik sa më të suksesshëm. Aksioni është përqëndruar në lirim të hapsirave publike të zëna nga shitësit ambulantë, kioskat, lodrat e vendosura përgjatë shëtitorës etj. Vetëm kësaj periudhe nga kjo strukturë janë marrë masa administrative me gjobë për: **45 subjekte me vlerë 318.000 lekë** ndaj subjekteve që janë konstatuar në shkelje të VKM-së nr. 171 datë 27/03/2019 “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”. Po kështu nga aksioni i ndërmarrë janë larguar **rreth 300 ambulantë** që kryenin veprimtari të jashtëligjshme si dhe janë marrë masa administrative me gjobë për: **33 ambulant me vlerë 28500 lekë**.



TASK-FORCA

Në fillim të muajit Korrik janë zhvilluar disa aksione të Task-Forcës vendore me Policinë e Shtetit, Policinë Bashkiake në bashkëpunim me Institucionin e Prefektit në zonat e plazhit të Durrësit ku janë kontrolluar gjithsej 140 subjekte. Në 17 prej tyre u morën masa për lirimin e plazhit nga çadrat dhe shezllonët e vendosur pa leje si dhe u proceduan penalisht në gjykatën e shkallës së parë Durrës. U identifikuan 25 plazhe publike. Të gjithë të tjerëve ju komunikua marja e masave dhe plotësimin i të gjitha kriterëve për zbatimin sa më të mirë të ligjit.



TASK-FORCA

Task Forca e ngritur në drejtim të luftës anti COVID 19

Task Forca e ngritur në drejtim të luftës anti COVID 19 e përbërë nga ISHSH Durrës, AKU e drejtuar nga Institucioni i Prefektit kanë kryer gjatë periudhës Janar-Qershor 2021 (pasi deri në këtë periudhë kanë vazhduar inspektimet e TF së ngritur) **rreth 5694** inspektime në subjekte të ndryshme, inspektime këto të plotësuara në google form. Gjithashtu nga grupe pune të ISHPSHSH dega rajonale Durrës, janë këshilluar dhe sensibilizuar për mbajtjen e maskës si një domosdoshmëri ndaj luftës anti COVID 19 **rreth 27394** qytetarë.

Janë kryer kontrole për vendosjen e barriers mbrojtëse te qytetarët në ambientet e jashtme. U këshilluan për mbajtjen e maskës dhe për domosdoshmërinë e mbajtjes së saj për uljen e riskut të infeksionit të shkaktuar nga Covid-19.



TASK-FORCA

Task Forca e ngritur në drejtim të luftës anti COVID 19

Janë inspektuar institucione arsimore në nivel qarku rreth **101 subjekte arsimore**. Subjektet janë inspektuar për kushtet higjeno sanitare dhe janë monitoruar dhe për COVID-19. Subjektet u gjetën në zbatim të protokollit përkatës të parandalimit të përhapjes së COVID-19.

Janë kryer **rreth 218** inspektime në subjekte të ndryshme për zbatimin e protokolleve përkatëse për parandalimin e përhapjes së COVID - 19.

Janë dhënë disa masë administrative për shkelësit e protokolleve përkatëse.



Komiteti Rajonal Antitrafik

KRAT gjatë periudhës Janar-Dhjetor të vitit 2021 e bazuar në planin e veprimit, i cili ka qenë i ndikuar nga kushtet e pandemisë për shkak të Covid 19. Janë zhvilluar tre takime të tryezave teknike në Mars, Maj, Shtator 2021.

Gjatë këtij viti, ndonëse në numër të kufizuar për shkak të pandemisë, të rëndësishme kanë qenë për KRAT Durrës edhe trajnimet e organizuara nën kujdesin e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik, në funksion të forcimit të strukturave shtetërore për trafikimin e personave.

Gjatë kësaj periudhe në qarkun e Durrësit janë evidentuar **7** raste të personave viktimë e mundëshme trafikimi.



Komiteti Rajonal Antitrafik

Për të gjitha këto raste të evidentuara vlen të theksohet bashkëpunimi i strukturave të KRAT i Policisë së Qarkut, Bashkisë Durrës dhe Shërbimit Social.

Fëmijët në situatë rruge, janë një tjetër problem i cili na shqetëson veçanërisht gjatë sezonit turistik. Për këtë arsye KRAT, nëpërmjet bashkisë Durrës në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë, Institucionin e Prefektit të Qarkut Durrës, por dhe gjithë aktorët e tjerë, kanë marrë masat për ngritjen e grupeve të terrenit.

Situata në lidhje me fëmijët që janë ndjekur e menaxhuar është gjithësej **139 raste**.



Komiteti Rajonal Antitrafik

Një nga avantazhet tona për këtë vit në këtë drejtim ka qenë funksionimi me kapacitet të plotë i qendrës për shërbimet emergjente, ku fëmijët vunerabël marrin shërbimet e nevojshme. Qendra për Shërbime Mbrojtëse, Fuqizuese dhe Emergjente për Fëmijën dhe Familjen është ngritur në Bashkinë e Durrësit, me iniciativën dhe kembënguljen e Word Vizion, si një model shërbimesh në kuadër të Reformës Kombëtare për Shërbimet Sociale dhe Strategjisë së Mbrojtjes Sociale.

Shërbimi i emergjencës (SHE)

33 fëmijë dhe 17 prindër (femra) në situatë rreziku të lartë kanë përfituar shërbimin emergjent, mbrojtje, strehim, mbështetje psikologjike, ushqim, veshmbathje dhe shërbim mjekësor, menaxhim rasti etj.

Ndergjegjesimi dhe parandalimi

Megjithëse kjo periudhë ka qenë e kushtëzuar nga pandemia, KRAT Durrës ka vijuar takimet on line me grupet e interesit për sensibilizimin dhe parandalimin e trafikimit.

Rekomandojmë mundësinë për ekzistencën e një baze ligjore për fëmijët që braktisin shkollën për shkak të emigrimit me familjet e tyre dhe kthehen përsëri.

Forcimi i bashkëpunimit me OJF për nxitjen e projekteve që kanë në fokus viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore,.

MBROJTJA CIVILE

Prefekti i Qarkut të Durrësit bazuar në Ligjin Nr 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” dhe Ligjin Nr. 45/2019, datë 18.07.2019, “Për Mbrojtjen Civile”, referuar informimeve dhe ndjekjes në mënyrë të vazhdueshme informacioneve paraprake nga IGJEUM, SHMU (Shërbimi Meteorologjik Ushtarak), MeteoAlb si dhe ERCC (Emergency Response Coordination Centre) dhe shërbimeve të tjera meteorologjike, sipas të cilit prej datës 22.01.2021 deri me datë 26.01.2021, pritej që në territorin e Republikës së Shqipërisë të kishte rreshje shiu intensive si dhe rritje të temperaturave, ku intensiteti i rreshjeve pritet të shkoj deri në 230mm/24orë në zona të caktuara.



MBROJTJA CIVILE

- ▶ Njoftimi i hershëm i publikut;
- ▶ Sigurimi i jetës së njerëzve;
- ▶ Sigurimi i gjësë së gjallë;
- ▶ Mbrojtja e banesave dhe pronave të tyre;
- ▶ Evakuimi i popullsisë në rast nevoje;
- ▶ Sigurimi i kushteve të popullsisë në vendstrehimet e tyre;
- ▶ Mundësimi i ndihmës në ushqime e veshmbathje për popullatën.
- ▶ Sigurimi i kushteve të gjësë së gjallë me ushqim dhe strehim;
- ▶ Ofrimi i ndihmës mjekësore.

MBROJTJA CIVILE

- ▶ ; Njoftimi i hershëm i publikut;
- ▶ Sigurimi i jetës së njerëzve;
- ▶ Sigurimi i gjësë së gjallë;
- ▶ Mbrojtja e banesave dhe pronave të tyre;
- ▶ Evakuimi i popullsisë në rast nevoje



MBROJTJA CIVILE

Tabela e personelit dhe e mjeteve			
N		Personel	Mjete
1	Institucionet		
1	Bashkia Durrës	189	21
2	Bashkia Shijak	23	5
3	Bashkia Krujë	50	4
4	Autoriteti Portual Durrës	7	2
5	Ndërmarrja Ujitjes e Kullimit	9	5
6	Prefektura	8	2
	SHUMA	286	39

MBROJTJA CIVILE

TABELA E DEMEVE NE TOTAL				
Nr	Qarku Durres	Familje te evakuara	Toka te permbytura Ha	Banesa te demtuara/Nenuje
1	Bashkia Durres	15	1440	360
2	Bashkia Kruje	-	500	48
3	Bashkia Shijak	1	173	50
	Total	16	2113	458

MBROJTJA CIVILE

- ▶ Prefekti i Qarkut bazuar në Ligjin Nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, Ligjin Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, si dhe në zbatim të shkresës: nr. 787/1 datë 06.04.2021 “Për marrjen e masave për përballimin e emergjencave verore, si dhe informim” të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, organizoi , në datën 18.05.2021, takimin e Komisionit të Mbrojtjes Civile dhe më gjërë, në nivel qarku, me qëllim marrjen e masave përgatitore në parandalimin, përballimin si dhe minimizimin me efikasitet të dëmëve që mund të krijohen nga zjarret, nisur dhe nga përvojat e deritanishme dhe problematikat e krijuara nga zjarret gjatë sezonit të kaluar.
- ▶ Në takim u kërkua përmbushja e detyrave ligjore të strukturave vendore në nivel qarku. Rëndësi merr, bashkëpunimi i strukturave të MC, MZSH, Sherbimit Pyjor etj. Pranë bashkive për rritjen e gadishmërisë të forcave dhe mjeteve, në përballimin me sukses të situatave gjatë periudhës së verës, shfaqies së vatrave të zjarrit në territor, duke ndjekur të gjitha procedurat, që nga informimi në kohë nga vrojtuesit deri tek ndërhyrja e menjëhershme për izolimin dhe shuarjen e tyre.



MBROJTJA CIVILE

- ▶ **Detyrat kryesore që u vunë në këtë takim ishin:**
- ▶ **Realizimi i mbledhjeve të komisioneve vendore të MC.**
- ▶ **Inspektimi i mjeteve zjarrfikse si dhe mjeteve ndihmëse në rastet e zjarreve.**
- ▶ **Përditësimi i skemave të informimit**
- ▶ **Rritja e bashkveprimit dhe përfshirja e grupeve vullnetare në raste zjarri.**
- ▶ **Marrja e masave për vendosjen e tabelave sinjalizuese në rruget me destinacion turistik.**
- ▶ **Ndjekja në kohë reale e situatave të zjarreve.**
- ▶ **Të bashkëpunohet në mënyrë të veçantë me strukturat e policisë së shtetit për identifikimin dhe venien përpara përgjegjësisë penale të autorëve zjarrvënës.**

TABELA E NDËRHYRJEVE OPERACIONALE PËR STRUKTURAT E PMNZSH VITI 2021. BASHKIA DURRËS

Nr.	NDERHYRJET OPERACIONALE	STATISTIKAT
1	Objekte Civile (banim)	51
2	Objekte, aktivitet shërbim(dyqan, salla, magazina etj.)	27
3	Objekte akomoduese turistike	1
4	Objekte Didaktike (shkolla, kopshte, cerdhe)	1
5	Objekte ku ushtrohet aktivitet tregëtimi me lëndë lehtesisht të djegshme	2
6	Objekte administrative	-
7	Objektet me rrezik te shtuar(uzina, fabrika te përpunimit të lëndëve djegëse)	1
8	Mjete transporti	47
9	Kullota, pyje, shkurre, barishte, mbeturina.	450
10	Ndërhyrje për shpëtim	85
11	Alarme fals	7
12	Nuk ka qënë e nevojshme ndërhyrja	8
13	Të tjera - Thithje uji - Shembje ndertesash nga IKMT	35
	TOTALI	720



TABELA E NDËRHYRJEVE OPERACIONALE PËR STRUKTURAT E PMNZSH VITI 2021 BASHKIA KRUIJË

Nr.	NDERHYRJET OPERACIONALE	STATISTIKAT
1	Objekte Civile (banim)	-
2	Objekte, aktivitet shërbim(dyqan, salla, magazina etj.), bazë ushqimore bagëtish	7
3	Objekte akomoduese turistike	-
4	Objekte Didaktike (shkolla, kopshte, cerdhe)	-
5	Objekte ku ushtrohet aktivitet tregëtimi me lëndë lehtesisht të djegshme	3
6	Objekte administrative	-
7	Objektet me rrezik te shtuar(uzina, fabrika te përpunimit të lëndëve djegëse, kabina elektrike)	5
8	Mjete transporti	23
9	Kullota, pyje, shkurre, barishte, mbeturina	91
10	Ndërhyrje për shpëtim	46
11	Alarme fals	5
12	Nuk ka qenë e nevojshme ndërhyrja	4
13	Të tjera Thithje uji Shembje	28
	ndertesash nga IKMT	
	TOTALI	212



TABELA E NDËRHYRJEVE OPERACIONALE PËR STRUKTURAT E PMNZSH VITI 2021. BASHKIA SHIJAK

Nr.	NDERHYRJET OPERACIONALE	STATISTIKAT
1	Objekte Civile (banim)	3
2	Objekte, aktivitet shërbim(dyqan, salla, magazina etj.), bazë ushqimore bagëtish	18
3	Objekte akomoduese turistike	-
4	Objekte Didaktike (shkolla, kopshte, cerdhe)	1
5	Objekte ku ushtrohet aktivitet tregëtimi me lëndë lehtesisht të djegshme	-
6	Objekte administrative	-
7	Objektet me rrezik të shtuar(uzina, fabrika të përpunimit të lëndëve djegëse, kabina elektrike)	1
8	Mjete transporti	6
9	Kullota, pyje, shkurre, barishte, mbeturina	103
10	Ndërhyrje për shpëtim (përmbytje)	110
11	Alarme fals	6
12	Nuk ka qenë e nevojshme ndërhyrja	3
13	Të tjera Thithje uji Shembje ndertesash nga IKMT	40
14	TOTALI	291



MBROJTJA CIVILE

PASTRIMI I KANALEVE DHE NGRITJA E ARGJINATURAVE.

Prefekti së bashku me Sektorin i Mbrojtjes Civile kanë kryer inspektimin në terren të punës në kuadër të pastrimit të kanaleve për ti paraprirë përmytjeve. Menaxhimi i kanaleve në kohën e duhur, para se të fillojnë rreshjet, bëri të mundur rritjen e efikasitetit të çdo strukture, për parandalimin, parapërgatitjen, përballimin dhe minimizimin e dëmeve nga rreziku i përmytjeve. Për vitin 2021 gjëndja e pastrimit të kanaleve paraqitet në tabelën e mëposhtme

Bashkia	Kanale të pastruara
Durrës	51.555 ml
Krujë	12.000 ml
Shijak	9.990 ml

Në rang qarku gjatësia e kanaleve të pastruara momentalisht është **77.545 ml**.



MBROJTJA CIVILE



MBROJTJA CIVILE

Nga ndërmarja Ujitjes dhe Kullimit janë pastuar 30800ml kanale të ujrave të larta dhe të para.

Këtë vit për të marrë masa sa më të mira për tie paraprirë përmbytjeve dhe për të ulur zonat me risk atje ku ka dalë nga shtrati lumi Erzen janë ndërtuar argjinatura:

Argjinatura në dy krahët e urës së qytetit të Shijakut me gjatësi 1600ml, mbron dy lagje të këtij qyteti. Argjinatura në lagjen Erzen të Njësisë Administrative Sukth me gjatësi 1200ml dhe argjinatura e kanalit të Tonës në fshatin Perlat me gjatësi 780ml.



MBROJTJA CIVILE

SITUATË EMERGJENTE

Nga data 24-28.9.2022 në qytetin e Krujës kemi patur një situatë emergjente pasi uji i pijshëm ishte i infektuar dhe si rrjedhojë pati qytetarë me probleme si me temperaturë, diarre, të vjella dhe dhimbje barku, të shtruar në spitalin e Krujës ku ju dha ndima e parë. Strukturat spitalore kanë qënë në gadishmëri të plotë duke u dhënë ndihmë shëndetsore banorëve që paraqiten pranë ambienteve të spitalit apo në mjediset shtëpiake. Medikamentet mjekesore nuk kanë munguar.



MBROJTJA CIVILE

- ▶ Nisur nga ndjekja dhe verifikimi i problematikës së evidentuar në terren, në qytetin e Krujës, Prefekti i Qarkut Durrës, së bashku me grupin e punës organizoi në mjediset e Nënprefekturës Krujë takim me drejtuesit e Institucioneve Vendore, me objekt situatën aktuale të uji të pijshëm dhe masat e ndërmarra. Drejtuesit e institucioneve pjesëmarrëse ishin: Zv/Prefekti, Drejtoresha e Spitalit Krujë, Drejtori i Shëndetit Publik, Administratori i U.K.K., Sekretari i Bashkisë Krujë, Drejtori i Shërbimeve Publike. Masat e marra ishin:



MBROJTJA CIVILE

- ▶ U zbrazën 4 (katër) depot e ujit që furnizojnë qytetin. U hodhën një sasi më e madhe e lejuar klori në ujë si masë paraprake deri në momentin e daljes së analizave bakterolo Banorët e qytetit janë lajmëruar për të zbazur depozitat vetjake dhe uji është ndërprerë që nga mëngjesi i datës 25 shtator, sipas raportimit të Bashkisë Krujë.
- ▶ Banorët e qytetit u lajmëruan për të zbazur depozitat vetjake dhe uji është ndërprerë që nga mëngjesi i datës 25 Shtator, sipas raportimit të bërë nga Bashkia Krujë.
- ▶ U morrën të gjitha masat e nevojshme duke çuar mostrat e ujit në Institutin e Shëndetit Publik për analizimin e tyre çdo ditë deri në përgjigjen përfundimtare.

MBROJTJA CIVILE

- ▶ Gjatë këtyre ditëve për banorët e qytetit të Krujës u siguroa uji i pishëm me 2 (dy) autobote me ujë nga U.K.D dhe 3 (tre) autobote nga M.M të cilët deri në orën 19:30 kanë shpërndarë ujë në lagjet e qytetit të Krujës. Bashkia Kruje siguroi nga firma e ujit Lajthiza 3 ton ujë dhe një pikë shumice “Hysni Kuqi” 1.8 ton ujë, bidona me koli, të cilat u shpërndanë në çerdhe, kopshte, spitali dhe familjet në nevojë.
- ▶ Sensibilizimi i qytetarëve për këtë situatë për të mos përdorur ujin nga rrjeti deri në marrjen e përgjigjeve që uji është normal.
- ▶ Bashkia e Krujës morri të gjitha masat për përballimin e situatës për desinfektimin dhe elementët e tjerë që i përkasin sigurisë së shëndetit pulik.

Gjithashtu prokuroria në bazë të ligjit ka kryer hetimin në ndërmarrjen e Ujës-jellës Kanalizime të Krujë, ku janë marrë disa dokumente, si dhe janë marrë në pyetje drejtues të këtij institucioni. Më datën 28 shtator çdo gjë u normalizua dhe qytetarët filluan të furnizohen me ujë nga rrjeti I qytetit.

MBROJTJA CIVILE

Problematika:

- ▶ Në momentin e ndodhjes së emergjencës nuk funksionon si duhet skema e lajmërimit.. si dhe largimi herë pas here në funksione të ndryshme të punonjësve të EC.
- ▶ Nga të tre bashkitë e qarkut nuk ka plan për rinovimin e mjeteve që shërbejnë për Emergjencat Civile.
- ▶ Bashkia Durrës në organikën e saj nuk ka drejtori të Emergjencave Civile.
- ▶ Bashkëpunimi institucional duhet të jetë më rezultativ.
- ▶ Mungesa e planizimit nga Ministria e Buqësisë për ngritjen e argjinaturave në zonat me risk të lartë përmbytje.
- ▶ Mungesa e rifreskimit të planeve të emrgjencave për situata të ndryshme për të gjithë strukturat operuese.

PERIUDHA E POST TËRMETIT TË 26 NËNTOR 2019

Gjatë periudhës vitit 2021, Institucioni i Prefektit i ka kushtuar një vëmendje të veçantë problematikës së post tërmetit kryesisht në drejtim të problematikave të paraqitura pranë Institucionit tonë nga qytetarë të ndryshëm sipas specifikave.

Gjatë gjithë periudhës Janar - Dhjetor 2021 në të tre bashkitë ka vazhduar procesi i rindërtimit të objekteve të dëmtuara nga tërmeti i 26 Nëntorit si dhe kanë vazhduar dhënia e granteve për dëmshprëblimet e baorëve të dëmtuar.

Është ndjekur dhe monitoruar ecuria e procesit për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga tërmeti i 26 Nëntorit në nivel qarku, janë inspektuar në mënyrë të vazhdueshme punimet për rindërtimin e objekteve të reja si dhe është monitoruar ky proces në të tre bashkitë. Në mënyrë specifike vëmëndja është përqëndruar në ndërtimin e lagjeve të reja, ecuria e punimeve dhe përfundimi i tyre në kohë dhe me cilësi.

Spektori i Zhvillimit Urban në bashkëpunim edhe me Spektorin Juridik dhe spektorë të tjerë ka bërë kontrollin e bazueshmërisë ligjore të vendiomeve të ardhura nga Këshillat Bashkiak të Njësite të Vetqeveriosjes Vendore Durrës, Krujë, Shijak në lidhje me të gjithë procedurat e ndjekura për procesin e post tërmetit.

Një proces i rëndësishëm ka qenë edhe ndjekja e hedhjes së shortit publik nga Bashkia Krujë, Durrës gjatë muajit Tetor 2021, për përfituesit, me qëllim akomodimin në njësite e banimit në objektet e reja, apartamente dhe njësi individuale, të ndërtuara në zonat e reja për zhvillim.

RINDËRTIMI

NR	EMËRTIMI	NUMRI I BANESAVE DS1-DS3 QË KANE MARRË GRANDIN E RIPARIMIT	TOTALI
1	BASHKIA DURRËS	14493 + 203	14696
2	BASHKIA SHIJAK	1480 + 672	2152
3	BASHKIA KRUIJË	2890	2890

Shënim: Shtesat janë listat progresive të familjeve që nuk i kanë marrë grandet e riparimit.



RINDËRTIMI

NR	EMËRTIMI	NUMRI I BANESAVE DS4				TOTAL
		TË PËRFUNDUAR	NË PROÇES	NUK KANË KANË FILLUAR	E KANË MARRE GRANDIN PËR RINDËRTI M VETË	
1	BASHKIA DURRËS	4	15	88		107
2	BASHKIA SHIJAK		61			61
3	BASHKIA KRUIJË			170		170



RINDËRTIMI

NR	EMËRTIMI	NUMRI I BANESAVE DS5				TOTALI
		TË PËRFUNDUAR	NË PROÇES	NUK KANË FILLUAR (TRANSFERUAR)	E KANË MARRE GRANDIN PËR RINDËRTIM VETË	
1	BASHKIA DURRËS	422	182	141		745
2	BASHKIA SHIJAK	375	53	46	263	737
3	BASHKIA KRUIJË	366	----	600	----	966

Shënim; Bashkia Durrës **141** familje kanë kërkuar transferim për tu vendosur në fushën e ndërtimit të Spitallës.

Bashkia Shijak **46** familje kanë kërkuar transferim për tu vendosur në lagjen lugina që po ndërtohet.

Bashkia Krujë **600** banesa individuale të shtrira në **6** NJ. Ad do të rindërtohen në trojet e veta duke u trajtuar me grand rindërtimi, por nuk ka filluar akoma, pritet lëvrimi i fondit.



RINDËRTIMI

NUMRI I BANESAVE KOLEKTIVE PËR RINDËRTIM (APARTAMENTE)

NR	EMËRTIMI	NUMRI I BANESAVE KOLEKTIVE PËR RINDËRTIM (APARTAMENTE)				TOTALI
		TË PËRFUNDUAR	NË PROÇES	NUK KANË FILLUAR	E KANË MARRE GRANDIN PËR RINDËRTIM VETË	
1	BASHKIA DURRËS	2	15			
2	BASHKIA SHIJAK	--	31	3	--	34
3	BASHKIA KRUIJË	325	240	170	--	735

Shënim; Bashkia Durrës. Banesat kolektive janë një numër i konsiderueshëm për tu prishur dhe për tu rindërtuar. Vazhdon puna janë në proces. Zona e re e zhvillimit në Spitalë është duke përfunduar infrastruktura ku do të ndërtohen **2000** apartamente.

Bashkia Shijak. Në banesat kolektive do të strehohen **521** familje.

Bashkia Krujë. Brenda zonës së re për zhvillim në qytetin e Krujës janë parashikuar të ndërtohen **240** apartamente. Sapo ka filluar ndërtimi. Ndërsa **10** pallate me **170** apartamente jashtë zonës së re për zhvillim po në qytetin e Krujës puna nuk ka nisur.



RINDËRTIMI

NR	EMËRTIMI	NUMRI I SHKOLLAVE TË NDËRTUARA			
		TË PËRFUNDUAR	NË PROÇES	NUK KANË FILLUAR	TOTALI
1	BASHKIA DURRËS	13+3	4	2+1	23
2	BASHKIA SHIJAK	6	--	2	8
3	BASHKIA KRUIJË	7+1	8+2	2	20



ADRESARI

Vëmëndje i është kushtuar edhe mbështetjes së projektit “Bashki të Forta” procesit të saktësimit të adresës së shtetasit, ku institucioni i Prefektit në zbatim të detyrave që shtroi Ministri i Brendshëm në datën 22.11.2021, ka zhvilluar takime të ndryshme për njohjen dhe përmbushjen e këtij procesi nga të gjithë individët si një proces mjaftë i rëndësishëm në rregullimin dhe sistemimin përfundimtar të saktësimit të adresave elektronike, çka krijon lehtësira jo vetëm në adresat për qytetarët për ti afruar secilit, ashtu sic duhet të gjitha shërbimet publike.

Gjatë muajit Dhjetor Prefekti i Qarkut Durrës ka zhvilluar takime informuese për regjistrimin dhe saktësimin e adresës së banimit **#ADRESAIME**, me të tre Bashkitë ku të pranishëm kanë qënë Drejtorët e Zyrave të Gjendjes Civile të Bashkive, Përfaqësues nga Bashkitë e Forta dhe punonjëset e Zyrave të Gjendjes Civile të Njërive Administrative si dhe me Degët Territoriale për këtë problem.



ADRESARI

Qëllimi i këtyre takimeve ishte raportimi i situatës aktuale mbi procesin e regjistrimit të adresave si dhe diskutimi i problematikave që njësitë administrative kanë hasur gjatë punës së tyre . Prefekti në fjalën e tij theksoi bashkëpunimin dhe informimin për të nxitur qytetarët që të deklarojnë dhe verifikojnë adresën e tyre të banimit si një element i rëndësishëm për marrjen e shërbimeve, nga atë financiare, deri tek shërbimit publike, mbrojtjes nga zjarri, apo shëndetësore. Regjistri Kombëtar i Adresave do të jetë burimi i vetëm i saktë dhe i përditësuar për të gjithë shtetasit, institucionet publike dhe bizneset. Regjistrimi i adresave është një detyrim ligjor dhe kusht që të mos vetëpërrjashtohet askush nga aksesin në shumë shërbime publike. Kudo ndodheni e në çdo kohë mund të aplikoni online nëpërmjet portalit [#eAlbania](#) ose duke shkuar vetë në zyrat e Gjendjes Civile në bashkinë ku banoni. Një adresë e saktë banimi të lehtëson aksesin në të gjitha shërbimet publike. Shtetasit që jetojnë brenda territorit të Shqipërisë përfitojnë të gjitha shërbimet qytetare.



PERIUDHA E MASAVE ANTI COVID-19


Gjatë gjithë periudhës së izolimit ndaj COVID-19, por edhe në vazhdimësi Institucioni i Prefektit ka ndjekur detyrat si më poshtë:

1. Janë mbajtur kontakte të vazhdueshme me strukturat e të tre bashkive Durrës, Shijak dhe Krujë lidhur me problematikat që ata kanë pasur gjatë periudhës së pandemisë.
2. Është ndjekur dhe dërguar pranë ZOS, Ministrisë së Brendshme informacione ditore lidhur me monitorimet dhe inspektimet nga Task-Forca AntiCovid-19, lidhur me zbatimin e rregullave/masave në përputhje me udhëzimet dhe protokollat e parashikuara me vendim të Komitetit Ndërmintrosor për Emergjencat Civile, në kuadër të masave dhe zbatimit të rregullave kundër Covid-19.



PERIUDHA E MASAVE ANTI COVID-19

3. Është dërguar informacion ditor pranë ZOS dhe Ministrisë së Brendshme lidhur me ecurinë e Qarkut Durrës për situatën e krijuar nga Covid-19. Për këtë është ndjekur në mënyrë periodike ditore ecuria e situatës epidemiologjike në të gjithë qarkun Durrës, **ku shifrat e gjendjes së janë që nga fillimi i pandemisë deri në fund të Dhjetor 2021 kanë qenë 15057** (Durrësi & Shijak **10846** dhe Kruja **4211** me COVID-19). Gjatë gjithë kësaj periudhe pandemie janë forcuar masat në fashione, call center, shkolla dhe bar-bufë- restorante, kopshte, cerdhe, si dhe janë njoftuar të gjithë për kujdesin e shtuar, është bërë kontrolli i personave dhe familjareve të prekur, të cilët janë urdhëruar të futen në karantinë dhe të zbatojnë të gjitha rregullat.
4. **Gjatë periudhës Janar-Dhjetoror 2021** nga informacionet e marra NjVKSH Durrës janë dërguar gjithësej **7320 mostra PCR** nga këto, nga Durrësi & Shijak **4934** dhe nga Kruja **2386**. Është punuar dhe me teste të shpejta ku për periudhën **Janar- Dhjetor 2021** janë realizuar për Durrës+Shijak rreth **17860** teste të shpejta nga të cilat **3773** rezultuar pozitiv dhe për Krujën janë bërë **4978** teste të shpejta nga të cilat **1189** kanë rezultuar pozitiv.



PERIUDHA E MASAVE ANTI COVID-19

Gjatë muajve Maj-Qershor është vënë re një përmirësim i ndjeshëm i situatës ku numëri i të infektuarve është ulur ndjeshëm, kjo falë edhe fillimit të procesit të vaksinimit. Kështu **Gjatë muajit Mars** filloi procesi i vaksinimit me çeljen e qendrës së vaksinimit të përqendruar në mjediset e Pallatit të Sportit, ku u vunë në dispozicion 10 poste vaksinimi, vaksinimi në fazën e parë për mësuesit duke kaluar më pas edhe me nisjen e procesit të vaksinimit masiv të popullatës në nivel qarku. Kryesisht është filluar me grupmoshat +80 e me rradhë. Fashat janë përcaktuar nga mjeku i familjes, i cili përcakton se cili nga të moshuarit do të vaksinohet i pari, sigurisht duke u nisur nga ditëlindjet.



PERIUDHA E MASAVE ANTI COVID-19

Gjatë muajit Prill ka vazhduar procesi i vaksinimit në qendrën e vaksinimit të përqendruar në sheshin “Liria. Gjatë këtij muaji vijoi procesi i vaksinimit masiv të popullatës në nivel qarku për grupmoshat deri në 55 vjeç. Gjithashtu është kryer edhe vaksinimi i personelit të shërbimit në hoteleri turizëm, me qëllim marrjen e masave për fillimin e sezonit të ri turistik. Më pas procesi i vaksinimit ka qënë i hapur për të gjithë grupmoshat deri në moshën 18 vjeç. Për periudhën Mars-Dhjetor 2021 janë kryer mbi 172244 doza vaksinimi për Durrësin dhe Shijakun, ndërsa për Krujën janë kryer 39201. Po kështu është ndjekur dhe monitoruar situata në bashkëpunim me strukturat e DVP të qarkut Durres të cilat kanë vazhduar përgjatë gjithë muajit me patrullimet dhe kontrollet në rrugë sheshe, lagje dhe plazhe. Gjithashtu nga policia ka mbajtur nën mbikqyrje personat që kanë rezultuar pozitiv me COVID-19 në të gjithë territorin e qarkut Durrës.



VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

- ▶ Institucioni i Prefektit ka kryer verifikimin e ligjshmërisë së akteve të nxjerra nga organet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore si edhe përpilimin e dokumentacionit të nevojshëm duke u shprehur për ligjshmërinë e këtyre Akteve, brenda afateve kohore (10 ditore) të përcaktuara qartë në Ligjin 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”.
- ▶ Në mbështetje të nenit 16 të ligjit 107/2016 “Për prefektin e qarkut”, janë verifikuar **380** akte të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore (Këshilli i Qarkut Durrës, Bashkia Durrës, Bashkia Krujë, Bashkia Shijak), nga të cilat:
 - ▶ - **369** janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore.
 - ▶ - **11** nuk janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore

VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

Verifikimi i Ligjshmërisë së Akteve të Organeve të Vetëqeverisjes Vendore

Verifikimi
në vend i
ligjshmëris
ë së akteve

Dërguar në
Gjykatë

Nr.

Njësi të
vetëqeveri
sjes
vendore

Akte të hyra
tek Prefekti

Të bazuara
në ligj

Të
pabazuara
në ligj

Të
rishqyrtuara
nga Nj.Q.V

Prog.

Prog

Prog.

Prog.

Prog.

Prog.

1

Këshilli i
Qarkut
Durrës

14

14

2

Bashkia
Durrës

166

166

2

3

Bashkia
Krujë

118

111

7

1

4

Bashkia
Shijak

82

78

4

2

Shuma

380

369

11

5

VERIFIKIMI I LIGJSHMËRISË SË AKTEVE TË ORGANEVE TË VETËQEVERISJES VENDORE

- ▶ Ka verifikuar bazueshmërinë ligjore të **380**akteve të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore nga të cilat 369 janë konfirmuar dhe 11 nuk janë konfirmuar për bazueshmëri ligjore, përkatësisht 7 vendime të pakonfirmuara të Këshillit Bashkiak Krujë dhe 4 vendime të pakonfirmuara të Këshillit Bashkiak Shijak.
- ▶ **Verifikimi në vend i ligjshmërisë së akteve**
- ▶ Në bazë të ligjit 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut“, neni 17 Sektori Juridik dhe Sektori i Monitorimit të Kompetencave Vendore dhe Funksioneve të Deleguara kanë bërë verifikimin në vend të ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të tre Bashkive të Qarkut Durrës. Kontrolli u përqendrua gjatë vitit në periudha të ndryshme dhe u krye në prani të Sekretarëve të Këshilliave Bashkiak përkatës.
- ▶ Nga verifikimet e kryera rezultoi se të gjitha aktet normative të Këshilliave Bashkiak ishin depozituar brenda afateve ligjore në institucionin e Prefektit për verifikimin e ligjshmërisë së tyre. Për shkak të situatës së pandemisë mbledhjet e Këshillave Bashkiakë janë bërë kryesisht on-line përmbajtja e të cilave është zbardhur më pas nga Sekretarët e Këshillave.

FUNKSIONET E DELEGUARA

Gjëndja Civile:

- ▶ Në zbatim të Ligjit Nr. 10129, datë 11.05.2009 “Për Gjendjen Civile” zyra e arkivit të gjendjes civile ka lëshuar çertifikata të shërbimit të gjendjes civile, duke plotësuar kërkesat e shtetasve për akte trashëgimie 500, për sigurime shoqërore dhe shëndetsore 1500, për jashtë shtetit për akt martese 620, për përdorim jashtë shtetit 100, për efekte gjyqësore 500, për dëmshpërblim për të persekutuarit politik 28, për fitim shtetësie 0, certifikata martese për akte noteriale 1000.
- ▶ Në mbështetje të Ligjit Nr.130/2013 janë lëshuar çertifikata për efekt korrigjimi të gabimeve materiale, për ndreqjen e të dhënave në regjistrat e zyrave të gjendjes civile pranë njësive administrative përkatëse si dhe fotokopjet e fletëve të regjistrave përkatës.
- ▶ Gjithashtu është ndjekur aktiviteti i aplikimit pranë zyrave të ALEAT-it. Procesi ka vijuar normalisht, janë inspektuar gjatë këtij viti zyrat e aplikimit në të tre bashkitë.



FUNKSIONET E DELEGUARA

Legalizimi i dokumentave:

Bazuar në VKM Nr.134 datë 07.03.2003 “Për vërtetimin dhe legalizimin e dokumentave të lëshuara në Republikën e Shqipërisë për përdorim jashtë vendit dhe të dokumentave të huaja për përdorim brenda vendit” janë legalizuar **28325 dokumenta** të lëshuara nga organet e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.



FUNKSIONET E DELEGUARA

Shqyrtimi i kundravajtjeve administrative në fushën e qarkullimit rrugor

Gjithashtu, në lidhje me kundravajtjet administrative, në zbatim të Udhëzimit Nr.687 datë 05.12.2013 “Për mënyrën e evidentimit dhe shqyrtimit të kundravajtjeve administrative, procedurat që ndiqen për masat administrative plotësuese dhe administrimi i gjobave në fushën e qarkullimit rrugor” janë shqyrtuar 46 praktika shkresore të dërguara nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, ndër këto 6 për alkool, 30 tejkalim shpejtësie.

Duke e krahasuar me vitin 2020 kemi një ulje drastike si: nga 246 raste të përgjithsme, nga këto 14 me alkool dhe 225 për shpejtësi.



GEN-PLAN

Për vitin 2021 është kryer 1 (një) konfirmim Gen-Plani dhe konkretisht të sipërfaqes pronë shtetërore në zonën kadastrale nr.1925, me nr.pasurie 20/6, me sip. 55000 m² me vendndodhje në N/B Hamallaj, Durrës, kjo në zbatim të V.K.M-së Nr.807, datë 11.12.2019 "Për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve për kalimin e pronës shtetërore në pronë private, në funksion të planeve të përgjithshme vendore".



SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

REALIZIMI I BUXHETIT 12 MUJORI 2021 PREFEKTURA

Nr	Emertimi	Planifikuar	Realizimi	Diferenca leke	Ne %
	SHPENZIME BUXHETORE TOTAL	31,625,000	28,736,000	2,889,000	91
1	PAGA PERSONELI	21,335,000	20,113.000	1221.000	94
2	KONTRIBUTE PER SIGURIME SHOQERORE DHE SHENDETESORE	3,668,000	3,329,000	338.000	91
3	MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA	6.479,000	5.150.000	1,329.000	79.5
4	TRANSFERTA PER BUXHETE FAMILJARE E INDIVIDE	143.430	143.430	0	100.0
5	INVESTIME	-	-	-	-

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

- ▶ Siç shihet nga tabela dhe nga grafikët buxheti u realizua në masën 90.87 % dhe zërat kryesorë të tij : Pagat me 94.00 %, Sig. Shoq. e Shëndetësore 91.00%, Mallra e shërbime të tjera 79.49%, investimet 0 %.
- ▶ Është bërë shpallja e vendeve vakante të punonjësve me status nënpunësi(gjithsej 4 vende), hedhja e të dhënave në sistemin HRMIS sipas kriterëve të kërkuara në zbatim të Ligjit 152/2013”Per statusin e nënpunesit civil”. Pas shpalljes së vendeve vakante, gjatë kësaj periudhe nuk është bërë shpallja e vendit Sekretar të Përgjithshëm.
- ▶ Janë bërë hedhjet e të dhënave të dosjeve individuale në këtë sistem dhe po punohet akoma për pasqyrimin e pervojës së punës duke ndjekur trajnime periodike pranë shkollës ASPA.
- ▶ U krye raportimi vjetor i nevojave për rekrutim në Ministrinë e Brendshme, si dhe gjendja mbi zbatimin e Ligjit 152/2013”Për statusin e nënpunësit civil” tek Komisioneri për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil.

SEKTORI FINANCË DHE SHËRBIME MBËSHTETËSE

- Financa dhe shërbimet mbështetëse gjatë vitit 2021 kanë mbështetur punën e Institucionit të Prefektit në zbatimin e ligjshmërisë dhe objektivave të shtruar për realizimin e tyre, në zbatim të Ligjit “Për Prefektin e Qarkut”, të Ligjit “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” si dhe të ligjeve e Udhëzimeve specifike ne fushën e financës.

Problematika.

- ▶ 1-Në drejtim të krijimit të kushteve më të mira në ambientet e zyrave të Prefekturës, si pasojë tërmetit të nëntorit të vitit 2019 janë të dëmtuara dhe amortizuara tualetet e Institucionit për të cilat janë kërkuar fonde për investime për rikonstruksionin e tyre në buxhetet e viteve 2020 dhe 2021 si dhe për 2022 nuk janë akorduar, mendojmë që ky problem do të realizohet me fondet e vetë institucionit të planifikuara për vitin 2022.
- ▶ 2- MB nëpërmjet DAP-it të na ndihmojë në plotësimin e vëndeve vakant të personelit , në mënyrë të veçantë për vëndin e Sekretarit të Përgjithshëm.

PRIORITETET E VITIT 2022

- ▶ Ndjekja e zbatimit të planit të rindërtimit pas tërmetit, vazhdimi i planit kombëtar të pastrimit për mbajtjen pastër të ambjentit.
- ▶ Respektimi i kuadrit ligjor për realizimin e programit qeveritar në arsim, shëndetësi, punësim, bujqësi, uji i pijshëm, energji, siguria publike dhe shërbimi zjarrfikës.
- ▶ Rritja e përgjegjësisë dhe anagazhimi i strukturave përkatëse në planifikimin dhe marrjen e masave për parandalimin e situatave të mundëshme emergjente dhe krizave në qark gjatë vitit 2022.
- ▶ Lufta kundër korrupsionit, forcimit të integritetit të institucioneve dhe promovimi i vlerave, si rritja e performancës në Administratën Publike në nivel qarku.
- ▶ Verifikimi i ligjshmërisë së akteve me karakter normativ të organeve, të njesive të qeverisjes vendore dhe zbatimi i ligjshmërisë në veprimtarinë e Institucionit të Prefektit.
- ▶ Shqyrtimi i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve duke i adresuar drejt zgjedhësve të tyre.
- ▶ Zbatimi i legjislacionit në drejtim të zhvillimit urban dhe mbrojtjes së mjedisit.
- ▶ Kontrolli i territorit, siguria dhe ruajtja e rendit publik
- ▶ Zbatimi i Buxhetit të Institucionit të Prefektit





FALEMINDERIT!